

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i Përgjithshëm

Autoriteti Portual Durrës me anë të kësaj procedure kërkon ofrimin e shërbimit të internetit të telefonisë dhe të atij televiziv ku prioritet ka zbatimi i standardeve për institucionet shtetërore në lidhje me fushën e TIK, me qëllim permisimin e shërbimit dhe edukimin e përdoruesve.

Duke u bazuar në standardet e përdorimit të internetit, rolin e Autoritetit Portual Durrës (APD) në forcimin e politikave dhe përfitimin ekonomik, si dhe duke përdorur infrastrukturen e tij të rrjetit, APD do të bëjë të mundur ofrimin e shërbimit të internetit për të gjitha godinat e zyrat e saj me vendodhje të ndryshme, duke u kthyer në një nyje të vetme aksesit interneti.

Duke pasur parasysh rëndësinë e vecante që ka përdorimi i internetit jo vetëm si mjet informimi, por dhe si infrastrukturë komunikimi midis entiteteve qendrore me ato lokale është e arsyeshme që shërbimi i internetit të trajtohet si shërbim kritik. Pra lidhjet kërkojnë të bëhen në mënyrë redundante (High Available) për të siguruar një shërbim të vazhdueshëm dhe çilesor 24 orë/ 24 orë në 7 ditë të javës. Gjithashtu si shërbim kritik kërkojnë instalimi i një Lidhje Sekondare (Backup Line) me anë të teknologjisë satelitore, ose teknologjisë tjetër, në mënyrë që të shmange çdo mundësi shërbimi e ardhur si pasoje e demtimeve të rrjeteve tokësore.

Sa më sipër, APD-ja kërkon të blejë shërbim interneti, telefonie dhe televizion nga një Operator Shërbimi Internet ISP duke kërkuar nga ky i fundit që të plotësojë patjetër këta indikatorë cilësie

1. SPECIFIKIMET E SHËRBIMIT TË KËRKUAR

Emërtimi	Madhësia/Lloji
Min i shpejtësisë Download të Internetit (Mbps) Linja Kryesore(Primary Line)	300
Min i shpejtësisë Upload të Internetit (Mbps) Linja Kryesore(Primary Line)	100
Min i shpejtësisë Download të Internetit (Mbps) BackUp Secondary Line	50
Min i shpejtësisë Upload të Internetit (Mbps) BackUp Secondary Line	10
Tipi i shërbimit	Internet i Dedikuar
Adresa IP Publike Statike	8 Adresa IP

Latency	<40ms
Jitter	<10ms
Maximum packet loss	<0,1%
Disponueshmeria e sherbimit:	Minimalisht 99.9% i disponueshem, (jo më shumë se 9 orë ndërprerje në vit)
Links (të dyja: Uplink dhe Downlink) Primare	Duhet të jenë simetrike
IPTV	Tring dhe Digitalb ose Ekuivalent
Lidhje telefonike per institucionin	SIP Trunk (min 30 thirrje te njekoheshme)
Numra telefoni fix virtual per zyrat te terminuar ne PBX	200 numra

3.NIVELI I SHERBIMIT

1. Siguria e Rrjetit

Operatori duhet te dije paraprakisht qe lidhja e ofruar prej tij do te ndahet ne disa godina te tjera. Ne rast sulmesh apo identifikimin te viruseve apo malware-ve nga ana e rrjetit te APD-se, operatori duhet te lajmeroje ne menyre sa me te shpejte APD-ne per problematiken dhe te bashkepunojne per zgjidhjen e problemit.

Atehere kur kjo nuk eshte e mundur, operatori mund te nderprese sherbimin perkohesisht deri ne eliminimin e problemit me miratimin paraprak te APD-se




Figure 1. Skema logjike e lidhjes

2. Instalimi I lidhjes

Lidhja e shërbimit do të merret përshër nga kompania, Operatori i Shërbimit ISP:

- Kjo lidhje do të jetë e dedikuar nga kompania drejt APD dhe do të jetë me fiber optike.
- Kompania duhet të sigurojë të gjithë aksesoret e nevojshëm dhe shërbimet teknike për realizimin e saj pranë APD.
- Në rast defektesh, kompania është përgjegjëse për mirëmbajtjen në efikasitet të kësaj lidhjeje.
- Kompania nuk mban përgjegjësi për çështje të rrjetit të brendshëm të APD. Infrastruktura dhe asetet e lidhjes janë prona e kompanive që do ta kryejnë ato.

3. Shërbimi teknik

Kompanitë duhet të paraqesin në ofertë termat e suportit dhe kontaktet për asistencë teknike, e cila duhet të jetë 24 orë, në 7 ditë të javës. Gjithashtu:

- Koha maksimale e pergjigjes ndaj defekteve te mundshme, pra koha maksimale gjate se ciles do te kryhet percaktimi i problemit do te vendoset afati i perafert i zgjidhjes se tij eshte 10 min.
- Koha maksimale e zgjidhjes se problemit, e cila nuk merr parasysh rastet e forcave madhore, nuk duhet te jete me shume se 150 min.
- Disponueshmeria e sherbimit kerkohet te jete 99.99%.Ne rast te mungeses se kesaj disponueshmerie, kompania do te ofroje ne menyre te perpjestuar per cdo 1 ore mungese sherbimi, 24 ore sherbim te shtuar ne periudhen kontraktuale.

Asistenca ne vend prane APD nuk do te perfshije kosto shtese. Kompania nuk do te pergjigjet me asistence teknike ne rast se problemet teknike do te shfaqen ne infrastrukturen e brendshme te APD.